

---

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar :  
Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:  
Pallati i Kongreseve ,  
Tirane Albania

Ne kemi audituar pasqyren (deklaraten) bashkalidhur te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate vitit kalendarik 2011, te Partise Demokratia Sociale - PDS, qe perfshin periudhen ushtrimore 01 Janar 2011 deri me 31 Dhjetor 2011, te mbyllura me 31 Dhjetor 2011.

**Paqyra është përgjegjësi e drejtimit të subjektit Partia Demokratia Sociale - PDS.**

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga drejtimi i Partise Demokratia Sociale- PDS, bazuar ne librin e llogarive dhe të rregjistrimit të posaçëm, miratuar si model dhe ne përputhje me kerkesat e raportimit mbi bazën e dokumentacionit mbartes te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara, konform me ligjin nr 9228 datë 29/04/2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin e kryer.**

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të veprojmë në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjate vitit kalendarike 2011 të mos përmbajë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumatat dhe informacionet e dhëna në pasqyrën bashkëlidhur. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të subjektit që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumatat dhe deklaratimet në pasqyrën financiare, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi i subjektit, si dhe një vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

*John E - 2*

Ne çmojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Ceshje ne Vemendjen Tuaj

Ne kerkojmë vemendjen tuaj në lidhje me ,

Detyra e subjektit, Partia Demokracia Sociale - PDS, është të përgatisë pasqyrën financiare mbi bazën e dokumentacionit mbartes të fondeve të perfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2011. (subjekti deklaron se nuk ka perfituar asnjë fond dhe nuk ka bërë shpenzime).

Opinion

Sipas mendimit tonë, duke marrë në konsiderat *Ceshje ne Vemendjen Tuaj*, pasqyra (deklarata) e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2011, Partia Demokracia Sociale – PDS, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e dokumentacionit mbartes të fondeve të perfituara dhe të shpenzuara.

Firma : ALB BB AUDITING SHPK  
TIRANE

Titullari : Lavdimir Fusha  
Eksperti Kontabël i Rregjistruar

*Lavdimir Fusha*  
*Fusha*

Datë : Korrik / 2012



Adresa: Rr. Bulv "Gjergj Fishta", Nd. 16, H.9, Ap. 20,  
Njesia Bashkiake Nr. 10, Kodi Postar 1001 ,  
Tiranë –Albania

Tel: + 2 427 019  
Mob. 0692067870